



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5708/prot.

Vlorë, më 24.03.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_.2026

**PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE PËRFITUES TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA” PËR VITIN 2026**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, të shkresës Nr.628/2prot., datë 23.01.2026 “Mbi fondet për programet e strehimit 2026” të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.1880prot., datë 28.01.2026, të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 113, datë 03.02.2026 “Mbi ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekteve dhe preventivave në zbatim të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara””, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

- I. Të miratojë listën emërore të familjeve dhe individëve përfitues të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” për vitin 2026 sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
- II. Lista e familjeve dhe individëve e miratuar sipas këtij vendimi do të përcillet pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit si pjesë e dosjes së aplikimit për të përfituar nga programet e strehimit që do të subvencionohen nga buxheti i shtetit për vitin 2026.
- III. Punimet për përmirësimin e kushteve fizike të banesave do të kryhen mbas përfitimit të fondeve të bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.



KRYETAR

Brunilda Mersini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5708/prot.

Vlorë, më 24.03.2026

LISTA EMËRORE E PËRFITUESËVE TË PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE VITI 2026"  
BASHKIA VLORË

Nr.	Emri/Atësia/Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018	Numri total i personave në familje	Niveli I të ardhurave mes.mujore	Lloji i dokumentit të pronësisë	Nr.pasurisë	Sipërfaqja e objektit m2	Vlera e preventivit me tvsh
1	Erjon Barjam Rapaj	Familje e komunitetit egjiptian Përfituese e ndih. Ekonom.+1 punësim	5	Ardhura sh. ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	286/4 ZK.3185	85	1,796,896.48
2	Sali Mamut Mahmutaj	Anëtar kom. Egj. Trajtohet me Ndhimë Ek.	1	Ardhura	Vërtetim posedimit	285/10 ZK.3185	71	1,799,954.12
3	Pranvera Barjam Mahmutaj	Anëtar kom. Egj. E moshuar në pension	1	shumë	faktik Nj.A.Shushicë	ZK.3185		
4	Enkeleda Spiro Shefiti	Anëtar kom.egj.familje njëprind.	3	ulëta				
5	Petro Nikolla Lapa	Kryefamiljari në pension 1 person me aftësi të kufizuara PAK	4	Ashu KAMCP	Çertifikatë pronësie	348/27 ZK.3185	64	1,589,175
6	Gezim Rakip Zenunaj	Familje e komunitetit egjiptian Përfituese e ndihmës ekonomike	2	0	Vërtetim posedimit	280/61 ZK.3185	51	1,599,643.59
7	Ermal Gezim Zenunaj	Anëtar I komunitetit egjiptian pa punë	1		faktik Nj.A.Shushicë			
8	Zare Kadri Kapllani	E moshuar. Anëtare e komunit.egjiptian 1/2 pension	1	Ardhura sh. ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	280/41 ZK.3185	60	799,543.00
9	Besnik Guri Lumaj	Të moshuar përfitues pension pleqërie Familje e komunitetit egjiptian	2	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	381/1/2-ND ZK.1826	55	999,322.89
10	Qerem Halil Alili	Familje me dy anëtar PAK përfitues të ndihmës ekonomike	4	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	296/36 ZK.3185	50	1,799,757.09

11	Andon Kadri Kamberaj	Të moshuar përfitues pension rural familje komunitetit egjiptian	2	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	280/46 ZK.3185	110	1,598,741.09
12	Dhimitër Andon Kamberaj	familje komunitetit egjiptian pa të ardhura	4					
13	Pajtim Isa Kapllani	Kryefamiljari në pension Familje e komunitetit egjiptian	2	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	280/20 ZK.3185	54	999,898.41
14	Rasim Riza Velaj	Familje e komunitetit egjiptian Familje ≥ 4 fëmijë, 1PAK	8	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	338/23 ZK.3185	72	1,796,515.37
15	Isuf Halil Alili	Të moshuar përfitues të pensionit rural	2	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	296/33 ZK.3185	70	999,340.34
16	Hektor Jonuz Baraj	Familje e komunitetit egjiptian Familje ≥ 4 fëmijë.Përfitues të nd.ekonom.	6	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	381/1/1-ND ZK.1826	62	1,810,960.36
17	Petraç Jorgji Qirraj	Kryefamiljari person PAK Përfitues I ndihmës ekonomike PAK	4	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	219/26 ZK.2639	65	1,799,906.09
18	Shkelqim Besim Aliraj	Përfitues I ndihmës ekonomike PAK	3	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	146/1-ND ZK.1552	82	1,594,798.89
19	Jemin Mustafa Habilaj	familje me të ardhura shumë të ulëta	5	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	338/9 ZK.3185	108	1,799,546.30
20	Florjan Pazait Hataj	Familje e komunitetit egjiptian pa të ardhura	3		Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	296/52 ZK.3185	50	1,598,741.09
21	Hasan Emin Sulejmani	Të moshuar përfitues të pension pleqërie + pension invaliditeti	2	Ardhura sh.ulëta	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	163/24/1-ND ZK.3446	45	999,737.06
22	Armando Niazi Velaj	Familje e komunitetit egjiptian Familje ≥ 4 fëmijë.Përfitues të nd.ekonom.	6	0	Vërtetim posedimit faktik Nj.A.Shushicë	280/50 ZK.3185	57	1,866,838.69
23	Zoto Isa Kapo	Të moshuar përfitues të pension pleqërie	2	Ardhura sh.ulëta	Çertifikatë pronësie	397/4 ZK.1569	65	999,963.52
24	Aleksander Nazif Kamberi	Familje e komunitetit egjiptian Familje ≥ 4 fëmijë.Përfitues të nd.ekonom.	9	0	Vërtetim posedimit AMTP	76 ZK.1060		1,997,808.39
25	Brahim Abas Veliu	Kryefamiljari invalid Familje pa të ardhura	3	0	Vërtetim pronësie	360/48 ZK.1060	38	1,599,588.01

Shuma

31,846,675.37



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5708/1 prot.

Vlorë, më 24.03.2026

RELACION

Për projektvendimin

**PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE PËR FITUES TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA” PËR VITIN 2026.**

Projektvendimi “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve përfitues për projektin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” mbështetet në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, dhe VKM Nr.454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën Nr.628/2prot., datë 23.01.2026 “Mbi fondet për programet e strehimit 2026” të regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.1880prot., datë 28.01.2026, ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2026, duke i ftuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen “Termat e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027”.

Edhe për vitin 2026 Bashkia Vlorë ka zgjedhur të aplikojë në “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, në projektin “Përmirësimi i kushteve fizike të banesave”. Edhe këtë vit janë përzgjedhur kategori familje dhe individë sipas përcaktimit në nenin 16, të ligjit 22/2018, banorë të fshatrave dhe të njësive administrative që jetojnë në kushte ekstreme varfërie si, të moshuar që jetojnë vetëm me të ardhura nga pensioni i përcaktuar sipas punësimit në ish-fermat dhe ish-kooperativat bujqësore, familje me individë me aftësi të kufizuara, familje anëtare të komunitetit egjiptian, familje me një prind, familje përfituese të ndihmës ekonomike, etj.

Bashkia Vlorë këtë vit ka zgjedhur të aplikojë në një program të tillë, sepse rregullimi i banesës prek drejtpërdrejt dinjitetin dhe sigurinë bazë të familjeve në nevojë.

Një banesë e sigurt dhe e përshtatshme nuk është thjesht strehë, por kusht për shëndet, stabilitet dhe integritet social. Kur përmirësohen kushtet e jetesës, familjet kanë më shumë mundësi të fokusohen te arsimit, puna dhe mirëqenia afatgjatë.

Prandaj e kemi zgjedhur këtë program: është një ndihmë konkrete, e menjëhershme dhe me ndikim të qëndrueshëm në jetën e përditshme të përfituesve.

Programi i PKFB për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për financimin e plotë ose të pjesshëm nga buxheti i shtetit të projekteve që propozohen nga njësitë e qeverisjes vendore.

Afati i paraqitjes së kërkesës për bashkëfinancim pranë ministrisë së bashku me dosjen e aplikimit këtë vit ka qenë data 16.02. 2026.

Dosja e aplikimit, e cila paraqitet pranë ministrisë bashkëfinancuese përmban midis të tjerash, edhe dy dokumente që duhet të jenë miratuar nga Këshilli i Bashkisë:

1. Deklarata për bashkëfinancim e miratuar parimisht me Vendim të Këshillit Bashkiak (e shprehur në përqindje/lekë )
2. Lista emërore përfundimtare e familjeve përfituese, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, e cila është objekt i këtij projektvendimi.

Referuar akteve ligjore e nënligjore, banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve janë :

- a) Banesat në rrezik shembje;
- b) Banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme

Kategori prioritare janë individë a familje:

-pa të ardhura, sipas përcaktimeve të shkronjës ç, të pikës 45, të nenit 2, të ligjit 22/2018

-minoritet rom dhe egjiptian

-familje që ka përbërje persona me aftësi të kufizuara

-familje e përbërë nga të moshuar me moshë mbi 65 vjeç që jetojnë vetëm

-familje me më shumë se katër fëmijë

-vajzat nëna, grua viktimë e dhunës, grua kryefamiljare, ku fëmijët në ngarkim të kenë moshën ≤ se 18 vjeç

-me të ardhura të ulëta dhe shumë të ulëta, sipas përcaktimeve në ligj

Shpallja publike në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Vlorë për njoftim të familjeve që janë në kushtet e përfitimit nga ky program është bërë në vitin 2019 menjëherë me daljen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, konkretisht të VKM Nr. Nr.454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.

Për informim të përditësuar mbështetur në ndryshimet në ligj, është bërë njoftim në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Vlorë në muajin mars 2025. Aplikimet për familjet e interesuara janë pa afat. Në çdo kohë ato mund të paraqesin kërkesën dhe e dokumentacionit pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun.

Procedurat nga strukturat e caktuara të bashkisë kryhen me hapjen e thirrjes nga ministria që mbulon strehimin drejtuar njërive vendore, së bashku me Termat e Referencës që përcaktojnë kushtet që duhet të plotësohen për tu kualifikuar, kategoritë përfituese të familjeve dhe kufinj të përfitimit për çdo kategori.

Kështu me urdhërin e brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 113, datë 03.02.2026 janë ngritur grupet e punës për të kryer verifikimin në banesat e familjeve që kanë aplikuar, përcaktimin së bashku me familjet të ndërhyrjeve të domosdoshme dhe të mundshme brenda fondit që i takon familjes, ose individit, me qëllim hartimin e projekteve dhe preventivave për çdo familje. Për vitin 2026 janë përfshirë në këto projekte 25 familje për 21 banesa, të cilat ndodhen në adresat e përcaktuara dhe me kushtet sociale e ekonomike si në tabelën bashkëlidhur.

Sa më lart, kërkohet nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim, si një nga kushtet për kualifikim për të përfituar nga fondet buxhetore të planifikuara për projektet e strehimit të vitit 2026.

  
**KRYETAR**  
**Brunilda Mersini**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 5708 prot.

Vlorë, më 24.03 .2026

MIRATOHET  
KRYETAR

*Brunilda Mersini*  
Brunilda Mersini



VENDIM

Nr. 7, datë 13.03.2026

**Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve që përfitojnë nga projekti i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026 dhe vlerat e financimit simbas preventivave për punimet e parashikuara në këto banesa.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, të shkresës Nr.628/2prot., datë 23.01.2026 “Mbi fondet për programet e strehimit 2026” të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.1880prot., datë 28.01.2026, të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 113, datë 03.02.2026 “Mbi ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektpreventivave në funksion të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur sot në datën 13.03.2026 në mbështetje të Vendimit Nr.3, datë 14.01.2026 “Për përzgjedhjen e familjeve që do të përfitojnë nga projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për vitin 2026” dhe në vlerat e financimit që do të përfitojnë këto familje simbas preventivave për punimet e parashikuara në to;

KONSTATOI SE:

1. Për të përfituar nga projektet e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026 janë përzgjedhur 25 familje, që jetojnë në 21 banesa me vendndodhje si vijon:

- 18 banesa në Nj.A. Shushicë, në fshatrat Risili, Shushicë, Mekat, Grabjan, Drithas
- 1 banesë në Nj.A. Orikum, në fshatin Dukat
- 2 banesa në Nj.A. Qendër, në fshatin Babicë e Madhe.

2. Grupi i punës me specialistët e përcaktuar në Urdhërin Nr.113, datë 03.02.2026 të

Kryetarin të Bashkisë Vlorë, të shoqëruar dhe në prani të punonjësve të njësive administrative përkatëse kanë shkuar në të gjitha banesat;

1. Për të bërë vlerësimin në fakt të gjendjes fizike të banesave dhe përcaktimin e punimeve që duhen kryer në banesa së bashku me familjarët.
2. Për të bërë matjet planimetrike në funksion të hartimit të projektpreventivave.
3. Për të bërë fotot dhe videot e të gjitha banesave në pjesët e amortizuara që kanë nevojë për përmirësime dhe ndërhyrje, brenda kufinjëve të financimit të përcaktuara në Termat e Referencës.
4. Për sigurimin e të dhënave që lidhen me kushtet familjare, ekonomike, sociale dhe të strehimit mbështetur në nenin 16 të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, për kategoritë e familjeve që përfitojnë dhe vlerat përkatëse të financimit.
5. Për të mbajtur dhe hartuar aktet e konstatimit, pjesë e dosjes së plotë të projektit që mbetet në bashki.
6. Për nënshkrimin e deklaratës së dakordësisë nga ana e familjeve/individëve për llojin e punimeve që do të kryhen në banesat e tyre.

Ndërkaq sipas akteve ligjore e nënligjore dhe dokumentacionit të kërkuar në shkresën e ministrisë për të përfituar, nga ana e familjarëve duhet të jetë plotësuar dokumentacioni si vijon:

1. Çertifikatë familjare brenda 3 muajve të fundit
  2. Adresën e banimit, vendndodhjen e banesës
  3. Dokument pronësie të banesës dhe çdo dokument tjetër që vërteton pronësinë mbi banesën që kërkohet të përfshihet në projektet e riparimit
  4. Dokumenta mbi punësimin, të ardhurat dhe problematikat sociale e shëndetësore
  5. Fotografji të banesës në pjesët e dëmtuara
  6. Kërkesë mbi llojin e punimeve që kërkojnë të kryhen
  7. Aplikim në sistemin online të strehimit, pasi kërkesat duhet të figurojnë në këtë sistem.
- Sa më lart, komisioni

#### VENDOSI:

1. Të miratojë familjet/individët që do të përfitojnë nga projektet e përmirësimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese për vitin 2026, si edhe vlerat e financimit për çdo rast simbas vlerave të preventivave të parashikuara për punimet që do kryhen.
2. Lista e familjeve dhe individëve përfitues, të dhënat për kushtet familjare, sociale, ekonomike, të dhënat për vendndodhjen e banesave të tyre dhe vlerat e financimit që që përfitojnë simbas preventivit të punimeve të detajohen në tabelën përmbledhëse.
3. Me përfundimet e mësipërme të përgatitet projektvendimi që do të paraqitet për të miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë në mbledhjen e muajit mars.

#### KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Kristaq Jorgaqi
3. Mirela Mishgjoni
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Elidon Jaho
7. Donald Leskaj

8. Bledar Toja
9. Genard Fegaj
10. Kanan Shakaj
11. Birçe Aliraj
12. Drini Harizaj
13. Drita Mustafaj